**VENDIM**
**Nr. 822, datë 19.12.2022**

# PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I LINJËS 110 kV BURREL–BULQIZË"

*(Ndryshuar me VKM nr. 759[1], datë 13.12.2024)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i linjës 110 kV Burrel-Bulqizë".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej *228 627.6 (dyqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë gjashtë) lekësh.*
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej *228 627.6 (dyqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë gjashtë) lekësh* përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., për pasuritë e shpronësuara.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, bën ndarjen e pasurisë 'arë' për sipërfaqen, objekt shpronësimi, dhe sipërfaqen që mbetet.
12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

---

[1] Vkm nr. 759, datë 13.12.2024 në pikën 2 shprehet;

*" 2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a."*

13. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

# LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTI "NDËRTIMI I LINJËS 110 kV BURREL–BULQIZË"

| NR. | PRONARI | | | TË DHËNA HIPOTEKARE | | | | | | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM | | | | Adresat | SHËNIME (KUFIZIME HIPOTEKARE, BARRË MBI PASURINË etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | ARË | | | | | ARË | | | VLERA TOTALE (lek) | | |
| | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati ose qyteti | Z. kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale | Arë ($m^2$) | Truall ($m^2$) | Ndërtesë ($m^2$) | Volumi | Faqe | Sipërfaqja ($m^2$) | Çmimi (lek/$m^2$) | Vlera (lek) | | | |
| | A | B | C | C | Ç | D | E | F | G | H | I | J | K | L | M | N | Y | Z | |
| 1 | Vera | Ismail | Lami | Fshat Burrel | 1325 | 273/6 | Arë | 1917 | | | | | | 38.4 | 114 | 4382 | 4382 | Fshati Burrel/NJA. Komsi/Bashkia Mat | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| | Igli | Sulejman | Lami | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Uendi | Sulejman | Lami | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | Ahmet | Hysen | Lika | Batër e Vogël | 1126 | 59/1 | Arë | 500 | | | | | | 31.6 | 114 | 3601 | 3601 | Fshati Batër e Vogël/NJA Komsi/Bashkia Mat | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 3 | Naze | Ibrahim | Çollaku | Batër e Vogël | 1126 | 52/2 | Arë | 3550 | | | | | | 74.0 | 114 | 8431 | 8431 | Fshati Batër e Vogël/NJA Komsi/Bashkia Mat | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 4 | Hakik | Qerim | Pasha | Batër e Vogël | 1126 | 55/9 | Arë | 4690 | | | | | | 46.2 | 114 | 5271 | 5271 | Fshati Batër e Vogël/NJA Komsi/Bashkia Mat | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 5 | Shaqir | Tahir | Balliu | Batër e Vogël | 1126 | 36/19 | Arë | 1330 | | | | | | 46.2 | 114 | 5271 | 5271 | Fshati Batër e Vogël/NJA Komsi/Bashkia Mat | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 6 | Vebi | Hysen | Miftari | Batër e Vogël | 1126 | 37/45 | Arë | 6125 | | | | | | 46.2 | 114 | 5271 | 5271 | Fshati Batër e Vogël/NJA Komsi/Bashkia Mat | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 7 | Avdi | Ramazan | Gjoka | Dom | 1507 | 12/1/1 | Arë | 14500 | | | | | | 72.3 | 114 | 8237 | 8237 | Fshati Dom/NJA Gurre/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| | Avni | Bajram | Gjoka | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Tane | Ibrahim | Gjoka | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Rustem | Bajram | Gjoka | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Veli | Ramazan | Gjoka | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 8 | Avdi | Ramazan | Gjoka | Dom | 1507 | 12/1/2 | Arë | 13500 | | | | | | 38.4 | 114 | 4382 | 4382 | Fshati Dom/NJA Gurre/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| | Tane | Ibrahim | Gjoka | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Rustem | Bajram | Gjoka | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Skender | Bajram | Gjoka | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 9 | Allaman | Qamil | Lleshi | Dom | 1507 | 45/2/2 | Arë | 2880 | | | | | | 46.2 | 114 | 5271 | 5271 | Fshati Dom/NJA Gurrë/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 10 | Sehit | Veli | Ceni | Kujtim | 2312 | 272/3 | Arë | 1500 | | | | | | 38.4 | 114 | 4382 | 4382 | Fshati Kujtim/NJA Suç/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 11 | Qazim | Isuf | Kerçiku | Kujtim | 2312 | 273/1/3 | Arë | 3300 | | | | | | 38.4 | 114 | 4382 | 4382 | Fshati Kujtim/NJA Suç/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 12 | Ibrahim | Man | Gurra | Kujtim | 2312 | 331/1/2 | Arë | 2250 | | | | | | 24.1 | 114 | 2747 | 2747 | Fshati Kujtim/NJA Suç/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| | Qamil | Man | Gurra | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Qerim | Man | Gurra | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Skender | Man | Gurra | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 13 | Lulzim | Hasan | Gurra | Kujtim | 2312 | 331/1/3 | Arë | 2200 | | | | | | 29.9 | 114 | 3409 | 3409 | Fshati Kujtim/NJA Suç/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 14 | Sami | Shaqir | Ndregjoni | Kujtim | 2312 | 414/2/2 | Arë | 3000 | | | | | | 74.0 | 114 | 8431 | 8431 | Fshati Kujtim/NJA Suç/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 15 | Ismail | Hasan | Gjini | Shulbater | 3439 | 525/14 | Arë | 6750 | | | | | | 106.1 | 114 | 12094 | 12094 | Fshati Shulbater/NJA Gurrë/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 16 | Bektash | Destan | Muça | Bershi | 1164 | 11/4 | Arë | 7250 | | | | | | 125.4 | 114 | 14300 | 14300 | Fshati Bershi/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| | Destan | Hazis | Muça | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 17 | Seit | Sadik | Hasa | Bershi | 1164 | 96/1 | Arë | 11320 | | | | | | 70.7 | 114 | 8063 | 8063 | Fshati Bershi/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 18 | Festim | Riza | Dardha | Fullqet | 1651 | 189/1 | Arë | 1800 | | | | | | 70.7 | 114 | 8063 | 8063 | Fshati Fullqet/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 19 | Faik | Abdullah | Jahja | Fullqet | 1651 | 269 | Arë | 2800 | | | | | | 70.7 | 114 | 8060 | 8060 | Fshati Fullqet/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 20 | Sami | Banush | Bala | Plesh | 2990 | 124/8 | Arë | 2600 | | | | | | 70.7 | 114 | 8063 | 8063 | Fshati Plesh/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 21 | Tilte | Ali | Musta | Plesh | 2990 | 159/2/10 | Arë | 4000 | | | | | | 70.7 | 114 | 8063 | 8063 | Fshati Plesh/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 22 | Agron | Masar | Çela | Plesh | 2990 | 237/3 | Arë | 6050 | | | | | | 179.6 | 114 | 20474 | 20474 | Fshati Plesh/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 23 | Agron | Masar | Çela | Plesh | 2990 | 175/6 | Arë | 11750 | | | | | | 179.6 | 114 | 20470 | 20470 | Fshati Plesh/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 24 | Sali | | Dedolli | Bejni | 1137 | 45/8 | Arë | 10000 | | | | | | 62.4 | 114 | 7115 | 7115 | Fshati Bejni/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 25 | Xhemal | Halil | Lleshi | Klos - Katund | 2164 | 7/1 | Arë | 4200 | | | | | | 54.0 | 114 | 6159 | 6159 | Fshati Klos Katund/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| | Luljeta | Abdi | Lleshi | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 26 | Kujtim | Bajram | Allmeta | Plan i Bardhë | 2982 | 75/4 | Arë | 1100 | | | | | | 54.0 | 114 | 6159 | 6159 | Fshati Plan i Bardhë/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 27 | Naile | Sali | Kurti | Plan i Bardhë | 2982 | 225/2 | Arë | 2600 | | | | | | 38.4 | 114 | 4382 | 4382 | Fshati Plan i Bardhë/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 28 | Aishe | Hysen | Allushi | Plan i Bardhë | 2982 | 218/6 | Arë | 1150 | | | | | | 62.4 | 114 | 7115 | 7115 | Fshati Plan i Bardhë/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| 29 | Hasan | Selman | Losha | Plan i Bardhë | 2982 | 169/8 | Arë | 6300 | | | | | | 54.0 | 114 | 6159 | 6159 | Fshati Plan ë Bardhë/NJA Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mat |
| | SHUMA | | | | | | | | | | | | | | | | 218208 | | |

*(Shtuar me VKM nr. 759, datë 13.12.2024)*

TABELA E SHTESAVE NË LISTËN E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN ME VKM-në NR. 822, DATË 19.12.2022, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I LINJËS 110 kV BURREL–BULQIZË"

| NR. | PRONARI | | | TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) | | | | | | | | | | VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM | | | Vlera totale | Adresa | SHËNIME: (KUFIZIME HIPOTEKORE, BARRË MBI PASURINË etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | Arë | | | | | Arë | | | | | |
| | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati/qyteti | Z. kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale | Arë | Truall | Ndërtesë | Volumi | Faqe | Sipërfaqe shpronësimi ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | | | |
| **30** | Bedri | Ramazan | Spahiu | Plesh | 2990 | 156/1/27 | Arë | 6100 | | | | | | 91.4 | 114 | 10,419.6 | 10,419.6 | Fshati Plesh/Nj.A Klos/Bashkia Klos | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| **Vlera Totale** | | | | | | | | | | | | | | | | | **10,419.6** | | |